



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli Ekspert shqyrtues 	Data e autorizimit të ekspertit 30.10.2020	Data e dorëzimit të raportit 09.11.2020	Nr. i lëndës: 865/20
--	---	--	---------------------------------------

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.10.2020, OE Ndërmarrja Tregtare Grafike “Blendi”-Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: ~~865/20~~ ^{865/20}, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shtypja e botimeve të ASHAK-ut”, me nr. të prokurimit: 231-20-6246-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës /ASHAK/.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim, vlerë e madhe, vlera parashikuar e kontratës: 56 000,00 €.

Data e njoftimit për kontratë 09.10.2020, kërkesa për rishqyrtim 23.10.2020, data e hapjes së ofertave 30.10.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë Neni 7, dhe 108/A të LPP-së

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Ne për tenderin me titull dhe nr të prokurimit të larte shenuar duke analizuar dosjen e tenderit kemi verejtur qe AK - Akademia e Shkencave dhe e Arteve te Kosovës, ka kërkuar mostra, duke e pare qe letra qe kerkohet është specifikedhe afati për dorezim të tenderit është shume i shkurter ne kemi kërkuar nga AK - SQARIME SHTESE, për substancën e letres ekuivalente por nuk na u është ofruar, pas refuzimit për dergim të substances ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim brenda afatit ligjor dhe me datën 27.10.2020 na dergon substancat e letres vetem dy dite para hapjes se tenderit por prape nuk e shtyn afatin për dorezimin e tenderit me preteksin qe jemi ne fund të vitit kalendarik edhe pse AK e din shume mire se kjo lloj letrë nuk gjendet në Kosovë e as në shtetet e Ballkanit për tu blere .

Duke e pare qe kompania jone po diskriminohet nga ASHAK -dhe po na pamundësohet ofertimi ne vendosem te bejme ankese bazuar ne LPP.

Kjo është kërkesa për sqarime shtese të cilën e kemi kërkuar te AK - Akademia e Shkencave dhe e Arteve te Kosovës me datën: 15.10.2020 citoj;

Ne kemi komunikuar me kompanitë ne regjion dhe leter ;INGRES nuk ka 170 gr por vetem 90 gr ose 160 gr ose heqni këtë gramature ose qe është ekuivalente na tregoni substancat gjithashtu ne e kemi porositur këtë leter 90 gr dhe 160 gr ne Europe pasi nuk gjendet ne Ballkan, prandaj kerkojme ta shtyeni afatin për dorezim te tenderit të pakten 10 dite nga dita kur ka qenë e planifikuar hapja e tenderit.

AK - Akademia e Shkencave dhe e Arteve te Kosovës /ASHAK/.

Ne kërkesën për sqarime shtesë nuk ka ofruar substancën e letres ekuivalente ashtu siç kemi kërkuar por vetem na ka thënë qe te jetë ekuivalente me fabiano onyx extra me cka asnjë prodhues nuk të dergon mostra me pershkrime te prodhuesve te tjere pa e treguar substancën .

Pas pergjigjies jo adekuate ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dhe kemi kërkuar po të nejtën gjë si tek sqarimet shtese kete herë AK - AKADEMIA E SHKENCAVE DHE ARTEVE TE KOSOVES- na ka derguar substancën e letres me datën 27.10.2020 por nuk e ka shtyer afatin për dorezimin e tenderit edhe pse pranimi të substances nevojiten te pakten 10 dite pune për sjelljen e mostrave ne Kosove.

Kerkojme nga OSHP QE NE BAZE TE LPP TA OBLIGOJ AK- Akademia e Shkencave dhe e Arteve te Kosovës TE NA I OFROJË SUBSTANCAT E LETRES DHE TA SHTYEJ AFATIN PER DOREZIM TE TENDERIT TE PAKTEN 10 DITE NGA DATA E PLANIFIKUARE HAPJES TE NA MUNDËSOHET OFERTIMI PASI QE DO TA RRISTE KONKURENCEN DHE DO TE KURSEHEJ BUXHETI I SHETITTE KOSOVES .

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në shtypjen e librave, në vlerë 84 000.00 euro (tetëdhjetë e katër mijë euro) në 3 (tre) vjetët e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.	1.Listën e kontratave të realizuara së bashku me referenca përkatëse apo raporte te pranimit të natyrës së ngjashme në shtypjen e librave, në vlerë 84 000.00 euro në 3 (tre) vjetët e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.
		2.Operatori ekonomik duhet të kenë staf profesional për shtypjen dhe përgatitjen e librit	2.Dëshmi për kualifikimin e punëtorëve për kryerjen e shërbimit (certifikata ose diploma përkatëse-kopje) a.Lista e punëtorëve grafikë bashkë me diplomat certifikatat relevante-min 2 b.Lista e libërldhësve bashkë me diplomat certifikatat relevante- min
		3.Operatori ekonomik duhet të sjellë mostrat	1. Mostrën e lidhjes së fortë solemne – (brendia e librit të jetë pa tekst, titulli Mostra e lidhjes së butë) a. riku në formë harku; b. qepje brosh me shirit ndarës të mëndafshhtë bojë të kuqe; c. kopertinat të forta me karton 2mm, faqja e fillimit dhe e mbarimit me letër 170gr Matte “ekuivalent” me Fabriano Ingres Ghiaccio 170 g/m2 me shtyp ofset kolor i plotë; d. mbështjellësi me thyerje të brendshme (vesh) 7.3 cm nga të dyja anët, letër 170gr Matte e plastifikuar “ekuivalent” me Fabriano Onyx Extra white 170gr/m2, shtypi ofset kolor i plotë. e. Forzeci me letër 160gr Matte “ekuivalent” me Fabriano Ingres Ghiaccio 160 g/m2. 2. Mostrën e lidhjes së butë – (brendia e librit të jetë pa tekst, titulli Mostra e lidhjes së butë) a. qepje; b. kopertina letër 350 gr/m2 matte e plastifikuar, shtypi ofset kolor i plotë. 3. Mostrat e lidhjes së fortë solemne të tre

			<p>leksikoneve – (brendia e librit të jetë pa tekst, titulli Mostra e lidhjes së leksikoneve)</p> <p>a. riku në formë harku;</p> <p>b. qepje brosh me shirit ndarës të mëndafshhtë bojë të kuqe;</p> <p>c. kopertinat të forta me karton 2mm, faqja e fillimit dhe e mbarimit me letër 170gr Matte “ekuivalent” me Fabriano Ingres Ghiaccio 170 g/m2 me shtyp ofset kolor i plotë;</p> <p>d. mbështjellësi me thyerje të brendshme (vesh) 7.3 cm nga të dyja anët, letër 170gr Matte e plastifikuar “ekuivalent” me Fabriano Onyx Extra white 170gr/m2, shtypi ofset kolor i plotë;</p> <p>e. forzeci me letër 160gr Matte “ekuivalent” me Fabriano Ingres Ghiaccio 160 g/m2.</p> <p>4. Mostrën e kutisë së kompletit të 3 leksiokoneve – (titulli në ballinë të kutisë Mostra e kutisë së leksikoneve)</p> <p>a. kuti e hapur kartoni e ripaketueshme;</p> <p>b. karton mikroval me dy shtresa, i mbështjellë me letër kunzdruk matte 350gr të plastifikuar;</p> <p>c. dimensionet e brendshme 12x18x24.8cm;</p> <p>d. mbishkrimi në ballinë të kutisë në teknikën e shtypit ofset.</p> <p>5. Mostrën e kutisë së fletoreve – (titulli në ballinë të kutisë Mostra e kutisë së fletoreve)</p> <p>a. kuti e hapur kartoni e ripaketueshme</p> <p>b. dimensionet e brendshme për vendosjen e fletoreve të specifikuara nën nr. 29 deri në nr. 98;</p> <p>c. karton mikroval me dy shtresa, i mbështjellë me letër kunzdruk matte 350gr të plastifikuar;</p> <p>d. mbishkrimi në ballinë të kutisë në teknikën e shtypit ofset.</p> <p>6. Mostrën e Fletores – (titulli në ballinë Mostra e fletores)</p> <p>a. Format i A4;</p> <p>b. qepje;</p> <p>c. kopertina letër 400 gr/m2 Matte e zezë me shtyp bojë të artë në teknikën e shtypit ofset.</p>	
--	--	--	---	--

	<p>4.Operatorët ekonomikë duhet të posedojnë teknologjinë dhe ta demonstrojnë atë para komisionit të vlerësimit a. Për shtypje offset kolor të plotë b. Për qepje me penj c. Për qepje me tel d.Për lidhje me ngjitës e. Për palosje të tabakëve f. Për plastifikim g. Për harkim të rikut</p>	<p>4.Dëshmi për pozicionin 4 (fotografitë), mirëpo AK gjatë vlerësimit e rezervon të drejtën e inspektimit të punishtes, ku mendohen të realizohen shërbimet, për të vërtetuar posedimin e teknologjisë së kërkuar dhe gjatë vizitës mund të kërkojë të shohë procesin e përgatitjes së mostrave të kërkuara në pikën 3</p>	
	<p>5.Deklaratë për afatin e liferimit</p>	<p>5.Deklaratë për liferim e vulosur dhe e nënshkruar, ku shtypja dhe dorëzimit i të gjithë materialit të kërkuar nga ASHAK-u për do të bëhet në afat prej 15 ditë pune</p>	

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI VLERËSUES

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të OE ankues lidhur me zgjatjen e afatit për dorëzimin e tenderëve, sqaron se OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 23.10.2020, duke kërkuar substancat e letrës pasi kjo letër është specifike. AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, me datë 27.10.2020 i dërgon substancat e letrës vetëm dy ditë para hapjes së tenderit por nuk e shtyn afatin për dorëzimin e tenderit me arsyetimin se është fundi i vitit kalendarik. Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK me datë 27.10.2020 i ka dërguar OE ankues

substancën e letrës dhe dërgimi i substancës së letrës është bërë 3 ditë para mbylljes së afatit për dorëzimin e tenderëve (30.10.2020), atëherë në këto rrethana është paraparë sipas nenit 53, par. 7 të LPP-së. që të zgjatet afati për dorëzimin e tenderëve edhe për dhjetë (10) ditë. Kjo dispozitë ligjore përcakton se kur autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtë se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues, dorëzimi substancës së letrës nënkupton sqarim të tenderit siç është përcaktuar në nenin 53 par. 7 të LPP-së. Gjithashtu, edhe kërkesa e OE ankues është e arsyeshme duke pasur parasysh faktin që në tregun tonë nuk ka asortiment të gjerë të produkteve të ndryshme dhe pothuajse shumica e produkteve varen nga importi. Për më tepër, AK gjatë zhvillimit të ndonjë aktiviteti të prokurimit duhet të sigurohet që të zgjerohet konkurrenca dhe jo të ngushtohet, ku përmes konkurrencës mund të arrihet edhe qëllimi sipas nenit 1 të LPP-së, si dhe ekonomiciteti dhe efikasiteti sipas nenit 6 të LPP-së. Andaj, eksperti konsideron se ky pretendim ankimor është i bazuar.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa AK të zgjatet afati për ofertim në pajtim me nenit 53.7 të LPP-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës /ASHAK/.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë